



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:280295
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05644313

KPPP.nr.1991/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Segment Kosova” Sh.p.k me NUI 810871328 të cilin e përfaqëson sipas autorizimit shoqëria e avokatëve RPHS Law L.L.C me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Trepça” Sh.a me NUI 811278747 me seli në Parkun Industrial në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.455/21 të datës 22.10.2021, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Trepça” Sh.a, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.455/21 të datës 22.10.2021, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Segment Kosova” Sh.p.k, ka caktuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.455/21 të datës 22.10.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës me numër 609-210-001-21 e datës 05.07.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit sipas faturës së lartcekura, t’ia paguaj shumën prej 1,997.04 €, me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbartim, duke deklaruar se dokumenti në bazë të cilave është marr vendimi përmbartues nuk është i përshtatshëm për përmbartim siç parashihet në nenin 27 të LPP-së duke i propozuar gjykatës që të anulohet urdhri përmbartimor.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret – fatura me numër 609-210-001-21 e datës 05.07.2021, në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti fatura, në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën

e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë tjetër. Andaj, duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si e tillë e njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente i besueshme dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Gjykata pati parasysh pretendimet e kreditorit se mallrat e furnizuara dorëzuara siç figurojnë në fletëpranimin nr.141/2021 janë identike me mallra që figuron në faturën objekt përmbarimor të lëshua nga kreditori, dhe fletëpranimi i lëshuar nga debitori është fakt i pakontestueshëm që dëshmon furnizimin me mallra nga kreditori e po ashtu që dëshmon se mallrat e dorëzuara janë konform kontratës, nga të cilat vërtetohet se malli është pranuar nga ana e debitorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturën mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia e detyrimit monetar që buron nga fatura, për faktin se fatura nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshme, mbi të cilat mbështet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohej në tërësi.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e kreditorit paraqitur në propozim për përmbarim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1991/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.